

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 208 Prot.

Tiranë, më 13.02 2017

VENDIM Nr. 28, datë 09.02.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2 të datës 09.02.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim projekti për "*Objekt multifunksional 10 kat, (2 kate shërbime dhe 8 kat banim) dhe 2 kat parkim nëntokë, ndodhur në kryqëzimin e rrugës "Mujo Ulqinaku" me rrugët "Andon Naci dhe "Hajdar Dushi" deri në ndërprerjen me rrugën "Dalip Tabaku", Durrës, zona arkeologjike "B", paraqitur nga subjekti "RAJFI" sh.p.k. si dhe konceptin e kryerjes së sondazheve arkeologjike të paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë (IA).*

VENDOSI:

1. Të miratojë konceptin e kryerjes së sondazheve arkeologjike të paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.
2. Subjekti "RAJFI" sh.p.k, për kryerjen e sondazheve arkeologjike, sipas Konceptit të kryerjes së sondazheve të paraqitur nga IA, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me IA, e cila do të realizojë ato dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të realizojë mbikëqyrjen e tyre.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

